



Republika e Kosovës - Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit

02.nr. 6481 /2020

Duke u bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Kosovës me nr. 03/L-040, neni 13 mbi aktet e Kryetarit të Komunës, Statutit të komunës Hani i Elezit neni 23.3 dhe neni 56, Marrveshjen e grantit me Nr 2019/414-194, programin për bashkëpunim ndërkufitar IPA II 2014 – 2020, ndërmjet Komunës së Hanit të Elezit dhe Komunës së Gazi Babës, Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit merr këtë:

V E N D I M
PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TENDERUESE

1. Merret vendim për procedurat e ofertave për projektin “Kanali i mbyllur” në fshatin Seçishtë i cili do të jetë në përputhje të plotë me aplikimin e aplikimit të komunës së Hanit të Elezit dhe udhëzuesit për procedurat kontraktuale për ndihmë financiare nga bashkimi evropjan.
2. Në përputhje me Planin e Prokurimit të miratuar në kuadër të projektit "Aktivitete të përbashkëta për mbrojtjen e mjedisit përmes përmirësimit të sistemeve të ujërave të zeza dhe kanalizimeve". Marrëveshja e Grantit Nr. 2019 / 414-194, Data 24/12.2019, financiar në përputhje të thirrjes së dytë për propozimin të projektit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II 2014 – 2020 ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë Veriore miratohet vendimi për relizimin e procedurave të cilat do të zhvillohen.
3. Komuna e Hanit të Elezit do të krijoj komision me të cilin do të bëhet hulumtimi i tregut, do të krijojë një listë të ofertuesve dhe të përgatisë raport lidhur me hulumtim të tregut.
4. Komisioni do të kryej, do të jetë përgjegjes edhe për vlerësimin e procedurës së projektit “ Kanali i Mbyllur”.
5. Do të respektohet procedura e thjeshtëzuar tenderuese, lënda e procedurës, “Kanali i Mbyllur” në fshatin Seçishtë Hani i Elezit, gjuha anglisht.



6. Baza ligjore:

IPA 2 programi për bashkëpunim ndërkufitar ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut,

- Rregullorja e BE-së nr.231/2014 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e miratuar me 11 Mars 2014 për krijimin e instrumentit për ndihmën e para antarsimit (IPA II)
- Ligjin e Prokurimit 04/L-042 dhe plotësimet dhe ndryshimet e mëvonshme, nga Kuvendi i Republikës së Kosovës
- Rregullorja e BE-së nr.236/2014 e Parlamentit Evropian dhe këshillit e miratuar me 11 Mars 2014 që përcakton rregullat dhe procedurat e përbashkëta për zbatimin e instrumenteve të ndihmës financiare të Bashkimit Evropian.

7. Dosja e tenderit do të përgaditet në përputhje me lloin e procedurës dhe rregullat e udhëzuesit praktik për procedurat kontraktuale për ndihmën financiare të Bashkimit Evropian, korrik 2019, të cilat i referohen programit të thjeshtëzuar të tenderit.

8. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit.

Data: 14.09.2020
Hani i Elezit

